

VENDIM
Nr. 871, datë 30.12.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 9, e vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Për vitin 2024, fondi i veçantë i institucioneve qendrore buxhetore dhe jobuxhetore, institucioneve të vetëqeverisjes vendore, njërive të fondeve speciale, institucioneve publike, të krijuara me ligj të posaçëm, ndërmarrjeve me kapital mbi 50% shtetëror, në varësi të institucioneve qendrore dhe vetëqeverisjes vendore nuk përdoret për veprimtari social-kulturore dhe shpërblimin e punonjësve. Ky përcaktim nuk zbatohet për:

a) punonjësit e institucioneve të rivlerësimit kalimtar, të cilët shpërblehen sipas vendimmarrjes së mbledhjes së anëtarëve;

b) punonjësit e rolit zbatues të Policisë së Shtetit për të cilët akordohet një ndihmë e menjëhershme në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

c) dy punonjës të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe një punonjës të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në masën e tri pagave mujore, fitues të eventit të organizuar në komunitetin global në menaxhimin dhe adresimin e kërcënimeve kibernetike.”.

2. Efektet financiare të pikës 1, të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar në zërin e shpenzimeve korrente në dispozicion për institucionet përkatëse të miratuara për vitin 2024.

3. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 1 të kryejnë veprimet financiare për zbatimin e këtij vendimi deri në datën 15.1.2025.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku